



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 253, dt.04.11.2016

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”, në mbledhjen e dt. 04.11.2016 Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, pasi shqyrtoi kërkesën për dhënie license në fushën e restaurimit për Shoqërinë “COMFORT 96” shpk, me drejtues teknik ark. Aleko Papakozma (RP 20),

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Shoqërisë “COMFORT 96” shpk me drejtues ligjor Z. Aleko Papakozma për pajisje me licensë restaurimi për kategoritë:
“CP. Projektim për restaurim në monumentet e arkitekturës për shoqëri projektimi”
“CZ. Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi”
me drejtues teknik ark. Aleko Papakozma.
2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, miratimin e kërkesës për pajisje me licensë restaurimi për Shoqërinë “COMFORT 96” shpk, për kategoritë:
“CP. Projektim për restaurim në monumentet e arkitekturës për shoqëri projektimi”
“CZ. Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi”
me drejtues teknik ark. Aleko Papakozma.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI